

PANAJOT ZOTO
TË JETOSH ME LAJMIN,
TË RREZIKOSH PËR TË VËRTETËN
PUBLICISTIKË

BOTIMET TOENA

PANAJOT ZOTO

TË JETOSH ME LAJMIN,
TË RREZIKOSH PËR TË VËRTETËN

Publicistikë

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2021

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Besa Vila

Korrektore letrare: Edona Marku

Përkujdesja grafike: Edona Marku

Kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-348-13-5

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollesha", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

www.toena.al

*Mjafton ta duash profesionin, se
rrugën drejt tij e gjen, për të marrë
pastaj gjithë kënaqësinë e dëshiruar.*

VËSHTRIM NË KOHË

Në fshatin tim të lindjes - ku errësira e mbrëmjeve ndriçohej nga drita e hënës që u vinte në ndihmë banorëve të përmbyllnin punët e mundimshme të ditës, ndërsa në kthinat e banesave ku varfëria shfaqej përmes një zbrazëtire të frikshme të atyre hapësirave, - llamba me vajguri ishte e vetmja mundësi për të parë njëri-tjetrin para orës së gjumit, e për të pritur sërish një ditë ku drita e diellit do t'ia linte vendin dritës së kandilit... Unë e kisha gjetur një zgjidhje. Nën atë dritë, aty në shtrojën përdhese, mbi dyshe-menë me dërrasa, kaloja orë të tëra, shpesh deri në këngën e parë të gjelave, duke lexuar, pse jo edhe duke shkruar. Shkruaja pa e menduar se rreshtat që hidhja në fletët e një fletoreje, të cilën e mbaja gjithnjë me vete, i duheshin kujt dhe kjo, sepse nuk pretendoja se ato e kishin një vlerë. Por nuk u ndala... Edhe në Delvinë, në qytetin historik, që shumëkush e quante provincë, pas emërimit në punë, tiktaku i orëve të ditës kishte të njëjtin ritëm. Ky qytet ishte stacioni i parë nga ku nisa rrugëtimin drejt qëllimit të jetës... Iu bashkova atyre pak "korrespondentëve vullnetarë" të fillimviteve '60 në këtë trevë të jugut të Shqipërisë, me disa bashkëpunime në gazetatat e kohës, organe zyrtare

të organizatave të masave si: “Fronti Demokratik”, “Bashkimet Profesionale” apo “Bashkimi i Rinisë”. Kam kultivuar në fushën e gazetarisë, siç kultivon bujku tokën për të marrë prej saj bukën dhe ushqimin e përditshëm. Dhe sot, pas më shumë se 5 dekada veprimtarie e punë intensive si gazetar, ia mbërrita ditës të ulem dhe të hedh në letër këto kujtime dhe mbresa.

Në gjithë këto vite kam shkruar, sa për vete aq dhe për të tjerët, për të përcjellë te lexuesi të vërtetat përmes lajmeve. Dhe në çdo hap e shkallë të ngjitur në këtë profesion i jam referuar mësimave të nxjerra prej shkrimtarit të madh Gabriel Garsia Marquez, që e cilësonte gazetarinë si “një profesion të pakuptueshëm dhe të pangopur”, çka do të thotë se puna e gazetarit nuk merr fund pas çdo lajmi, përkundrazi. Botimi i një lajmi apo i një shkrimi nuk të lë të qetë asnjë çast, deri në një fillim të ri të punës për të thënë diçka tjetër...

Prodhimtaria e veprimtarisë sime në këtë fushë, për sa i përket kohës, i takon dy sistemeve: atij para viteve '90, ku mediet, sipas studiuesve të sotëm, ishin organizatore kolektive të masave dhe instrument i përçimit të direktivave, urdhrave e sloganeve nga maja e pushtetit të masat; dhe atij pas viteve '90 kur në vend u vendos pluralizmi politik e bashkë me të edhe pluralizmi mediatik, me konceptin e lirisë së shtypit, i kufizuar fillimisht te liria për debatin politik. Duke parë e gjykuar sot punën e disa dekadave, ndarë në dy sisteme politike, ajo që kam kuptuar dhe që e kam bindje lidhet me vlerën e produktit të gazetarit. Ndërsa dje nuk flitej për çmim të produktit (shkrimin) të gazetarit, por për vlerën e tij, sot pak rëndësi kanë

vlerat (e shkrimeve si mjet edukimi e informimi), ndërkohë rendet pas çmimit, që nënkupton fitimin për çdo produkt të krijuar. Ndaj në gjithë këtë tranzicion politik dhe mediatik pas vitit '90, edhe perceptimi i publikut për gazetarin, veç të tjerash, lidhet me statusin e tij pasuror, teksa gazetarët gjykohen si parellinj, dhe profesioni i gazetarit si mundësi për të fituar etj. Natyrisht nuk është kështu. Gazetaria nuk të shpie në pasuri, më së shumti mund të të shpjerë në mirëqenie. Edhe te ne, në skakierën e gjerë mediatike të qindra e mijëra gazetarëve, mund të bëhet diferenca, ku vërtetohet thënia e Idro Montanelli-t (studiues italian i fushës) se “Gazetari i pasur është një gazetar që qelbet, sepse e ka përdorur zanatin për të afruar të tjera objektiva...”

Kam anuar gjithnjë nga krahu i shumicës, të cilët nuk e kanë përdorur profesionin e gazetarit për privilegje, qofshin politike a pasurore. Kam shkuar gjithnjë pas së vërtetës, dhe nuk kam bërë kompromis për ta mohuar atë. Më duhet të pranoj se gazetaria është e politizuar. Ka qenë e tillë gjatë periudhës komuniste dhe, po e tillë është edhe sot. Dje për shkak të njëpartitizmit dhe mungesës së pluralizmit, çka do të thotë se gazetaria ishte në shërbim të pushtetit dhe sistemit. Sot politizimi merr ngjyrimë social-ekonomike, që do të thotë se është interesi ekonomik, nevoja për të përballuar jetesën ajo që i detyron, përgjithësisht, gazetarët të ndjekin si “qen” besnik interesat e botuesve dhe krerëve të tyre, të cilët në shumicën e rasteve janë të lidhur me politikën. Kjo është gjithçka që më ka mësuar përvoja. Kam arritur të qëndroj e të mbijetoj në profesion përgjatë gjithë

këtyre viteve, duke u përballur me realitetet pa shkelur parimet dhe moralin. Nëse dje, në asnjë rast nuk kam shkruar “lajle-lule” për regjimin apo udhëheqësit, sot kam pranuar nivelin modest të jetesës, duke refuzuar konformizmin, apo heshtjen - përballë nevojës për të folur me zë kritik.

Në hershmërinë e punës sime si “korrespondent vullnetar”, në Delvinë, por dhe më pas si profesionist në gazetën lokale (organ i komitetit të partisë të Rrethit, Sarandë) nuk jam ulur vetëm për të shkruar, por edhe për të mësuar e lëvruar këtë lloj arti të veçantë. Më është dashur të mësoja se cilat janë mjetet e informimit. Çfarë është lajmi, karakteristikat dhe llojet e lajmit. Gjuha që përdor gazetari dhe çfarë duhet të ketë parasysh ai kur shkruan një lajm, etj, etj. Nuk mund ta fsheh gëzimin që ndjeva ditën e botimit të shkrimit tim të parë në gazetën “Zëri i Popullit”. Ajo ditë prilli e vitit 1963 do të shënonte pikënisjen në rrugën e ngjitjes së shkallëve të këtij profesioni, që nuk më ka sjellë vetëm gëzime apo nuk më ka dhuruar vetëm kënaqësi, por edhe shqetësime e privacione në jetë. Shumëkush që më lexon sot edhe mund të rrudhë buzët për çka po them, për vlerësimin e ditës së parë kur kam hyrë në “dyert” e “Zërit të popullit”. Nuk e mohoj faktin se ajo gazetë, më e madhja e kohës, ishte organ i Partisë së Punës, që drejtonte vendin, po është aq e vërtetë se ajo ishte edhe shkolla, përfaqësuesja e ajkës së gazetarisë shqiptare, organi ku provuan dhe lanë gjurmët e punës së tyre ata që u bënë “mësuesit” e gazetarisë shqiptare, të mëdhenjtë: Ismail Kadare, Dritëro Agolli e pena te tjera të ndritura të gazetarisë

dhe letërsisë sonë. Të botoje në këtë gazetë nuk ishte thjesht një privilegj, por dhe një konfirmim i shkallës së profesionalizmit. Përsëri lexuesi i sotëm do të më thotë “I ke shërbyer atij regjimi...” E kam një përgjigje edhe për këtë. Në asnjë rast nuk kam pranuar të përdorem apo të vihem në rolin e servilit. Mediat në atë regjim (“Zëri i Popullit” e para ndër to) kishin për mision e detyrë transmetimin e informacioneve dhe të dhënave, që ishin në përputhje me përfitimet ideologjike dhe politike të partisë-shtet, dhe jo vetëm për mua; kjo ishte normalitet. Nuk mund të them sot se e shikoja atë sistem dhe atë pushtet si një diktaturë apo armike të lirisë dhe të të drejtave të njeriut. Jo! Gënjen kush thotë të kundërtën (me ndonjë përjashtim) dhe që pretendon se ka bërë Kasandrën. Di vetëm një gjë, se përgjatë asaj periudhe kam bërë shkrime kritike. Unë dhe shokët e mi kemi lëvruar gjini (që sot janë harruar) si “fejtoni” e shkrime që satirizonin drejtues e nëpunës shteti për të meta e mangësi në punë etj., etj. Postkomunizmi (e kam fjalën për gjithë këto vite të tranzicionit demokratik të vendit) më gjeti sërish në krahun e të gjithë atyre që gazetarinë nuk e kanë parë si mjet fitimi e për privilegje. I shërbeva partisë (PS-së) jo si shërbëtor, por si transmetues i vlerave dhe rolit të saj në qeverisje dhe në opozitë, duke qenë i qartë në vijën ndarëse mes një anëtari, detyrave të tij partiake dhe misionit të gazetarit, për të mos qenë konformist me pushtetin e çdo kohe.

FILLIMI

Delvina e fillimviteve '60 ishte një qytet ende i “virgjër” në këndvështrimin e sotëm urban. Nuk mund të dalloje ndonjë ndryshim thelbësor qysh nga koha kur udhëtari Evliya Çelebi, në vitin 1776, do ta përshkruante këtë trevë si “një qytet të zhvilluar me shumë hane e dyqane”. Qendra, apo pazari siç i thoshin vendasit (lagjes së sotme “Vare”), ishte, si të thuash, memoria historike e shekujve të kaluar. Po ato hane që qarkonin sheshin qendror me rrapet shekullore në disa pika të tij, dhe një resht me dyqane e kafene (atëkohë u thoshin mejhane) në qendër. Ngjitur me hanin e Gjatajve ishte kinemaja, një tip kapanoni mbuluar me eternit, vendi ku mblidhej mbrëmjeve rinia e qytetit për të parë filmat e kohës. Kishte edhe një skenë ku ngjiteshin grupet amatore dhe zhvilloheshin aktivitete artistike që i jepnin Delvinës gjallëri...

Frigoriferi ishte e para vepër e rëndësishme e industrisë ushqimore, e ndërtuar dhe e vënë në shfrytëzim në vitin 1962, e që do të pasohej me një rrjet tregtie më funksional, me disa fabrika, punishte, ndërmarrje komunale apo ndërmarrje të punimeve artizanale, duke formësuar kështu punëtorinë ose “klasën punëtore”, kontingjentin e parë të specialistëve të arsimuar dhe të administratorëve të rinj. Dy shkollat 7-vjeçare dhe dy shkollat e mesme, me disa dhjetëra

arsimtarë. Spitali me një kolektiv të vogël mjekësh e infermierë. Shtëpia e kulturës dhe ajo e pionierit, me specialistë e muzikantë profesionistë e amatorë. E gjithë kjo përbënte shtratin e “farishtes” që do të jetësonte, në vijimësi, ndryshimet në këndvështrimin urban, jetësor e social të qytetit; mentalitete të reja, por dhe psikologjinë e bashkëjetesës në komunitet.

Ajo që ka mbetur e skalitur në memorien time është afiniteti, dashamirësia dhe respekti që banorët e qytetit kishin për jabanxhinjtë (të ardhurit), qofshin këta mësues, mjekë, ushtarakë apo specialistë të fushave të ndryshme që punonin e jetonin këtu. Isha një ndër ata, që gjeta mes këtyre banorëve ngrohtësi dhe provova solidaritetin shoqëror të kolektivit të njerëzve me të cilët kam punuar e jetuar.

Kishte ndër ne, në kolektivin ku punoja, por jo vetëm, edhe nga ata që silleshin në mënyre servile me autoritetet, drejtuesit e ndërmarrjes apo udhëheqësit partiakë, sikundër dhe tipa të tjerë që kërkonin përgjegjësi, duke e shndërruar ambicien për karrierë në një qëllim dhe manierë të sëmurë karrieriste. Provova ta tipizoj këtë fenomen në një shkrim. Ishte i pari shkrim që më botonte gazeta më e madhe e kohës, “Zëri i Popullit”, i cili prodhoi jo vetëm debat, por edhe hatërmбетje. Dhe ja si.

Agimi nuk e lëshonte kurrsesi postin e kryetarit të organizatës së bashkimeve profesionale në kolektivin e punonjësve të frigoriferit. Ishte viti i tretë që ai pretendonte të rizgjidhej me “konsensus”, ashtu si edhe

herët e tjera. Ai e fillonte kështu pikën e dytë të rendit të ditës që i kushtohej zgjedhjeve: “Kalojmë në pikën e dytë. Kush e do fjalën të propozojë nënkryetarin?”. Ngrihej dikush nga salla dhe i thoshte se përpara duhet të propozohet emri i kryetarit dhe pastaj i nënkryetarit. Dhe ai përgjigjej: “Dakord, dakord, ashtu është, por... kryetari dihet. Ja ku më kini”. Një e qeshur masive dhe mbledhja vijonte me propozimet për nënkryetarin dhe për anëtarët e kryesisë... Në zgjedhjet për drejtuesit e organizatave të Bashkimeve Profesionale në prill-maj të vitit '63, Agimit i ngeci sharra në gozhdë dhe e pa veten thjesht në rolin e anëtarit. Ç'kishte ndodhur? “Dale, dale se boll vite e bëre kryetarllëkun. Ka edhe të tjerë kolektivi, që mund ta bëjnë më mirë se ty këtë punë”, kishte thënë Xhemali, shoku i tij i ngushë, dhe propozoi një tjetër emër, i cili u votua unanimisht, edhe pse nuk ndodhej në sallë...

Agimin nuk e nxinte vendi, e kish pritur sfiduesin mëngjesin tjetër me potere. “Po ti, more... paske qenë si mola i fshehtë. Ma punove pas krahëve”, i kishte thënë dhe nuk ia dha dorën për ta takuar. Berti kishte shtangur nga fjalët dhe qëndrimi i Agimit. Të tjerët, që ishin aty rrotull, ia shkrepën gazit, ndërsa Agimi vazhdonte të fajësonte Bertin, se kishte përgatitur “kurthin” për t'i marrë postin. “Për ç'kurth e ke fjalën, kur unë nuk di asgjë dhe as kam dëshirë të bëhem kryetar... pse për këtë je inatosur? Jam gati të dorëhiqem dhe të propozoj kandidaturën tënde”, i kishte thënë Berti.

Ky episod, në dukje si një komedi, shpërfaqte në vetvete një realitet jo të izoluar të kohës, një dukuri, një fenomen, që si pa e kuptuar krijonte kastën e drejtuesve (të zgjedhur a të emëruar) konformistë me

pushtetin... Këto po mendoja gjatë gjithë asaj nate të pagjumë, kur vendosa të shkruaj mbi këtë temë. Sistemova mendimet dhe i hodha në letër...

Shkrimi me titull “Karrieristët”, botuar në rubrikën “Tema shoqërore”, kishte bërë bujë në të gjithë qytetin, ndërsa në kolektivin e punonjësve të frigoriferit gazeta kalonte dorë më dorë dhe çdokush që e lexonte miratonte gjithçka që trajtohej në atë shkrim. Agimi, edhe pse në shkrim nuk përmendej ndonjë emër, kishte tjetër qëndrim. Shokët më thanë se kishte marrë inat dhe kishte thënë që shkrimin e kisha bërë qëllimisht për ta diskredituar. E gjeta të ulur te stoli pranë peshores në sheshin ku bëhej ngarkim-shkarkimi i mishit. E përshëndeta, por nuk më foli. “S’ke pse më mban kokën mënjane dhe më thua se kam shkruar kundër teje”, i thashë. “Ke shkruar më tha, - duke e ngritur zërin, dhe më tregoi gazetën “Zëri i Popullit”, të cilën e mbante në dorë. - Ja... e shikon?!” “Çfarë të shikoj, - i thashë, dhe lexova: ... Nuk e kemi fjalën për karrierizmin si karakter, as për shfaqjen e dëshirës për karrierë, pasi synimi dhe dëshira për të bërë karrierë është normale. Fjalën e kemi për karrierizmin si dukuri negative, si një shfaqje që bie ndesh me moralin e shëndoshë, pasi karrierizmi si i tillë frymëzohet nga egoizmi. A nuk ka ndër ne tipa të cilët me egoizmin që tregojnë duan të duken mbi të tjerët, duan të thonë se ‘këtu jam vetëm unë’ se ‘vetëm unë mund ta bëj këtë detyrë’? Këta e vënë veten në qendër, duke përjashtuar çdo kënd tjetër. Kjo është fryma e një egoizmi banal, e përjashtimit të tjetrit në emër të kënaqësisë që të jep synimi për t’u bërë dikush, pra karrierizmi...”

“Ja, e shikon? - më ndërpreu Agimi, dhe vazhdoi. - Ja këto i thua për mua. Unë jam ai që...” E ndërpreva duke i thënë se në shkrim nuk përmendej asnjë emër dhe nëse ai e identifikonte veten me karrieristin unë s’kisha fjalë për të thënë. Shokët që e ndiqnin debatin i thanë ta linte këtë “sherr” dhe, dikush me shpoti shtoi: “Prit vitin tjetër të të zgjedhim prapë kryetar”.

Agimi e mbajti “inatin” vetëm një javë. Përgjithësisht ishte njeri pozitiv, zemërgjerë, që pranonte shakanë, se edhe ai vetë gërricej me shokët.

Arsimtarët e Buzit

Të udhëtoje nga Delvina në Buz duhet t’i bëje mirë llogaritë. Jo për arsye sigurie a frike nga ndonjë keqbërës rrugësh, por nga pamundësia për të siguruar transportin kur të duhej ta bëje këtë udhëtim... Atë mars të vitit 1968 vendosa t’i bëja një vizitë motrës që banonte dhe punonte si mësuese në atë zonë të thellë malore të Tepelenës. M’u desh të prishja gjumin herët në mëngjes për të udhëtuar deri në Tepelenë me një makinë tip “ZIS”, që bënte rrugën (si shumë automjete të tjera) Sarandë-Memaliaj, për të ngarkuar qymyr në minierë. Posta (një kamion me një mbulesë mushamaje dhe me stola druri), që bënte linjën e Beratit, ishte gati për nisje kur mbërritëm në Tepelenë, dhe Neziri, shoferi i “ZIS”-t, me të cilin udhëtova nga Delvina, më mundësoi nisjen me të, edhe pse jashtë vendeve (në këmbë). Rruga matanë urës së Leklit ishte e paasfaltuar dhe tepër e ngushtë, por më pak e bezdisshme sesa pjesa tjetër. Pasi la Këlcyrën, pastaj Ballabanin, makina e postës nisi ngjitjen e

mundimshme, duke gulçuar në një rrugë malore plot kthesa, derisa u duk disi e lehtësuar në kalim të qafës së Kiçokut. Në Buz u ndal diku nga ora 14:00. Zbrita dhe iu drejtova klubit, aty ndanë rrugës, për të marrë pak veten nga ky udhëtim i stërlodhshëm...

Buzi ishte një qendër administrative (lokalitet) ku, veç disa depove të grumbullimit, një baxhoje dhe lokaleve të tregtisë, ishin edhe zyrat e kooperativës bujqësore, që përfshinte disa fshatra të asaj zone deri në kufi me Beratin; zyrat e lokalitetit, qendra shëndetësore dhe shkolla 8-vjeçare. Si kureshtar nga natyra dhe këmbëngulës në atë që mendoja se duhej parë nga afër, u futa në rrugicat e fshatit dhe trokita në dyert e depove, punishteve dhe institucioneve. U prezantova si korrespondent i gazetës “Zëri i Popullit”, për të parë reagimin e atyre që punonin e shërbenin atje. Më kujtohet sesi dy gra të reja (më vonë mësova se ishin nëpunëse të lokalitetit) ndryshuan pamjen e fytyrës dhe, gati me servilizëm, më ftuan të ulesha, ndërsa shitësja e dyqanit ushqimor më thoshte se furnizimi ishte i rregullt dhe se banorët ishin të kënaqur. Ndryshe më fliste Thoma Dardeli, një mjek (i lindur në fshatin Muzinë dhe i larguar familjarisht pas luftës në Tiranë) i internuar në këto anë dhe që shërbente prej disa vitesh në qendrën shëndetësore të Buzit. “Mos e pastë fatin tjetër kush të vij këtu”, thoshte ai, pa u frikur se fjalët e tij do të përcilleshin lart. Do ta mirëkuptoja dhe do t’i jepja të drejtë, edhe për shkak se jeta e tij po zvarritej në këto anë, larg familjes dhe fëmijëve, vetëm e vetëm se kishte thënë ca të vërteta që, sipas tij, nuk mund të pranoheshin nga nomenklatura.

... Pas takimit në shkollë me mësuesit “beqarë” (nga rrethet Gjirokastër, Sarandë dhe Himara), të emëruar pas studimeve në Buz, kafenë e paradrekës e pimë në klub. Pastaj më ftuan në dhomën ku banonin për të bërë, siç thanë “adetin”...

Edhe kthimi në Delvinë nuk ishte i lehtë. Gjatë asaj nate kishte rënë borë që e kishte pamundësuar lëvizjen e mjeteve në atë rrugë malore... Në Delvinë mbërrita në fund të javës, por nga mendja nuk më dilte ajo çka kisha parë në atë shkollë dhe në dhomën e mësuesve: në mes të dhomës një tavolinë me copa buke, e mbushur me thërime dhe... disa libra. Krevate teke me batanije hedhur mbi to. Një dritare me perde të palara, dyshemeja me dërrasa e pafshirë, mbase prej ditësh. Gjatë gjithë rrugës, nga Buzi në Delvinë, kjo pamje nuk më shqitej nga sytë e mendjes, dhe përshtypja e krijuar më shtynte gjithnjë e më shumë drejt idesë së një shkrimi, jo me qëllim fyerjen e mësuesve dhe cenimin e dinjitetit profesional të tyre, por si nevojë për të tërhequr vëmendjen dhe për të treguar se mësuesi duhet të rrezatojë kulturë dhe me modelin e tij duhet të përcjellë mesazhe pozitive në çdo aspekt dhe në mjedisin e punës dhe të banimit... U ula dhe të gjitha ngacmimet e përjetuara në ato dytri ditë i hodha në letër.

Shkrimi me titull: “Shokë arsimtarë të Buzit puna juaj e dobët nuk ju nderon”, u botua në gazetën “Zëri i Popullit” atë javë, më 23 janar 1968. Në shkrim theksoja faktin se shkollën 8-vjeçare të Buzit në rrethin e Tepelenës, e frekuentonin rreth 100 nxënës, që vinin nga fshatrat e zonës me një terren të thyer malor, e që duhet të sakrifikonin në mënyre të

përditshme, për të vijuar rregullisht mësimin. Edhe vetë mësuesit, disa në moshë shumë të re, nga rrethet e tjera, ishin duke sakrifikuar, larg familjes, por, gjithçka ishte e justifikuar pasi ata sakrifikonin në emër të një çështjeje të madhe, “edukimit të brezit të ri”, sikundër thoshte partia. Ndaj, shkruaja “... Njeriun tonë nuk duhet ta mposhtë asnjë vështirësi, aq më tepër arsimtarin, komisarin e dritës...” Po ç’ndodh me arsimtarët e Buzit? Ata siç duket nuk jetojnë me kohën dhe kanë rënë në indiferentizëm, duke nënvlerësuar shumë aspekte të edukimit politik, moral dhe estetik të rinisë shkollore. Drejtori i shkollës, shoku Qirjako Fani, duke mos e vlerësuar drejt detyrën e ngarkuar, ka lejuar parregullsi dhe liberalizëm të theksuar, duke ulur kërkesën e llogarisë ndaj arsimtarëve. Ka heshtur përballë faktit që orët e mësimit bëhen jo të plota, që arsimtarët hyjnë e dalin sipas qejfit në klasa... Familjariteti i sëmurë mes tyre ka zëvendësuar përgjegjësinë në kryerjen e detyrës nga drejtori i shkollës, i cili iu jep leje pa kriter, dhe kur ndonjë nga mësuesit merr guximin dhe ia bën vërejtjen për këtë fakt, ai ia pret shkurt: “Këtë e di unë. Këtu jam unë drejtor, jo ti”. Më tej, në shkrim rendisja mangësi të tjera, si mungesa e gazetës së murit, tabela e të dalluarve, që nuk kishte asnjë fotografi a emër nxënësi, terreni sportiv i boshatisur... dhe më tej, në shkrim, me një sens kritik trajtoja misionin e arsimtarit jo thjesht si mësimdhënës, por dhe si edukator e misionar, për të çuar të renë edhe në fshat përmes aktiviteteve edukative, takimeve dhe bisedave me fshatarët, gjë që nuk e bënin arsimtarët e Buzit. Në shkrim nuk lija pa theksuar faktin se mësuesit e Buzit ishin deficitar

në porositë e dhëna nga seksioni i arsimit dhe nga pushteti i rrethit për të ndihmuar në ndërgjegjësimin e banorëve për një higjienë e pastërti më të mirë në mjediset e banesave dhe të fshatit. E si mund ta bënin ata kur vetë ishin një shembull i keq? Ndaj, theksoja në shkrim “fatkeqësisht arsimtarët beqarë të Buzit e kanë katandisur dhomën e gjumit si mos më keq...”

Një javë më pas gjeta në dhomën e gjumit një letër mbi tavolinë. Mbi zarf ishte emri i motrës, ndaj e hapa me nxitim nga kureshtja për të mësuar arsyen e dërgimit të një letre, gjë që nuk kishte ndodhur më parë. E hapa zarfin me nxitim dhe lexova... Nga fjalët e përdorura në letër dukej se motra ishte e revoltuar dhe shprehte pakënaqësinë e kolektivit të mësuesve të Buzit. “Na bëre hasëm me shokët...”, shkruante motra... Ç’kishte ndodhur? Ato ditë, pas botimit të shkrimit, ia kishin behur në Buz kontrollorët e seksionit të arsimit. Me porosi të qendrës ishte mbledhur me urgjencë organizata-bazë e partisë, ndërsa instruktorët e komitetit të partisë dhe punonjës të Komitetit Ekzekutiv kishin marrë në analizë problemet e ngritura dhe kishin ushtruar kontrolle të imtësishme për zbatimin e programit mësues, edukativ e sportiv në shkollë. Drejtorin e shkollës e transferuan me paralajmërim për largim nga puna dhe tre arsimtarëve të tjerë iu dha vërejtje me paralajmërim... E vërteta është se nuk e kisha menduar që puna do të arrinte deri këtu dhe ndjeva një keqardhje për çka kishte ndodhur me arsimtarët e Buzit. Në fakt ua thashë se do të shkruaja për gjendjen që pashë atje, të cilën, një nga mësuesit e justifikoi me faktin se: “Prisnin thirrjen për t’u mobilizuar. Do të shkonin ushtarë...”.

BASHKUDHËTARË ME “FITOREN”

Telefonata

Zyra e drejtorit të shtëpisë së kulturës ndodhej në katin e tretë të ndërtesës shekullore. Nga ballkoni i katit të dytë, me parvaz metalik, thuhej se para delvinjotëve kishin folur: i pari, Osman Gazepi, dhe, më pas, Enveri, një vit para se të përfundonte ndërtimi i hidrocentralit të Bistricës, nga ku do të jepte edhe njoftimin e gëzueshëm të elektrifikimit të të gjithë vendit në dy-tri vitet e ardhshme.

Isha duke punuar për një material skenik (një skeç për estradën amatore të shtëpisë së kulturës), kur zilja e telefonit më shkëputi nga mendimet me atë cingërimën shurdhuese. Ngrita receptorin dhe në anën tjetër të telit u dëgjua zëri i centralistes:

- Panajoti je?
- Po, unë jam, - thashë.
- Qëndro në linjë, sepse të kërkojnë nga komiteti i partisë, - u dëgjua të thoshte centralistja.

Nuk arrita ta pyesja se kush më kërkonte, sepse në çast më lidhi me kërkuesin.

- Jam Spirua, - u dëgjua të thoshte marrësi në telefon.

- Spirua? Cili Spiro? Pekua? - pyeta duke cituar mbiemrin e instruktorit të edukimit.

- Jo, jo. Jam Spiro Çavo, sekretari...

Nuk e di pse ndjeva një lloj tundimi, ndaj dhe hezitova për pak çaste të përgjigjesha. “Ç’ne sekretari i Komitetit të Partisë”, mendova, ndërsa shoku Spiro po më pyeste në telefon: “Më dëgjon?”.

- Ju dëgjoj, shoku Spiro, urdhëroni, - nxitova t’i përgjigjesha.

- Nesër në orën 10:00 të pres në zyrë, - tha, dhe e mbylli telefonin.

Incidenti me qendrën e zërit

Mbeta me receptorin e telefonit në dorë, duke përsëritur “urdhrin”. Përse më donte sekretari i Komitetit? - Ishte një pyetje për të cilën nuk e kisha një përgjigje. Të ketë ndonjë problem me shkrimin “Frika e thashethemeve”... apo shkrimin “A duhet ta lëmë të lirë kohën e lirë”? (të botuara ditë më parë në gazetën “Zëri i Popullit”). Të jetë ankuar ndonjëri nga emrat e vënë në shënjestrën e kritikës si përgojues i vajzave që aktivizoheshin në aktivitete të ndryshme kulturore, apo i “prindit konservator”, që pengonte vajzën për t’u aktivizuar në estradën amatore të qytetit? Jo, jo! S’ka pse... Fundja asnjë prej tyre nuk më është ankuar, ngushëlloja veten, dhe prapë mendja më punonte për të gjetur një arsye, një rast debati që mund të jetë bërë problem, aq sa unë duhej të paraqitesha te sekretari për edukimin. Dola nga zyra dhe në çast u kujtova se

duhej hapur qendra e zërit, pasi ishte ora e lajmeve. “O... pa, e gjeta”, fola me vete dhe kalova nëpër mend ngjarjen e para disa ditëve me qendrën e zërit...

... Ishim në dhomën e provave. Punonim për numrin e ri të estradës me aktorët amatorë, ndërsa u dëgjuan hapa të rënda që ngjitnin me nxitim shkallët prej dërrase të asaj godine të vjetër. Pastaj një trokitje pa kurrfarë etike në derë, e cila u hap me vërtik dhe brenda hynë ata: Petrua, sekretari i Këshillit të qytetit dhe Masari, inxhinieri i Ndërmarrjes Pyjore. Nuk pritën t’i pyesja për arsyen dukshëm të shqetësimit të tyre. Në turfullim e sipër njëgojësh më thanë: “Mbylle atë dreq radioje!”. “Radion? Po pse, çfarë...”, po ngatërroja fjalët nëpër gojë. Dhe ata ma kthyen: “Si çfarë. Je mbyllur këtu dhe nuk dëgjon që qendra e zërit gjëmon nga këngët serbe. Edhe lajmet i dha jo shqip, por serbisht... Kjo nuk ka ndodhur ndonjëherë, që njerëzit këtu, në Delvinë, të dëgjojnë muzikë serbe. Do të mbash përgjegjësi për këtë”. Mbeta pa fjalë. Ata e zbrazën dufin mbi mua, sepse sipas tyre “kisha humbur vigjilencën revolucionare” (nuk arritën deri në etiketimin: “veprimtari armiqësor”) dhe u larguan, duke më kërkuar të fikja qendrën e zërit.

Ç’kishte ndodhur? Ishte maji i vitit 1971, kur nuk bëhej fjalë për televizion dhe jo vetëm në Delvinë. Madje edhe një radio në lokalet e shërbimit ishte një luks. Në këto kushte shtëpia e kulturës ishte e ngarkuar me detyrën (prej shumë vitesh) që të garantonte transmetimin publik të programeve të “Radio Tiranës”. Për këtë qëllim shërbente (si qendër zëri)

një radio e markës “Sonneberg”, e konsumuar në vite, e lidhur kjo me një rrjet altoparlantësh, shpërndarë në qendër të qytetit. Atë ditë, shigjeta që ndërronte stacionet duket se, për shkak të konsumimit, kishte vetëlëvizur prandaj në megafon dëgjohej muzikë serbe... “Me siguri, për këtë incident më kërkojnë në komitetin e partisë”, thashë.

Në zyrën e sekretarit

Zyra e sekretarit të edukimit, shokut Spiro, ishte në katin e parë të godinës trekatëshe të Komitetit të Partisë, atje ku sot është shatërvani, në lulishten qendrore të qytetit. Duke ecur në korridor, para se të trokisja në derën ngjyrë kafe të zyrës ku duhej të paraqitesha, një nga instruktorët e aparatit më përshëndeti duke më uruar. Nuk e kuptova psenë e urimit të tij, dhe koha nuk ishte e mjaftë për të përpunuar në aparatin e kujtesës ngjarje të shkuara... “mbase për shkrimin”, thashë dhe trokita...

Sekretari më priti ngrohtë, me një buzëqeshje “jo e veçantë për mua”, mendova. Gjithnjë ai shfaqej me një natyrë të qeshur në mjediset dhe bisedat publike. Më ftoi të ulesha në poltronin pranë dritares dhe më pyeti për numrin e ri të estradës.

- Hë, si shkojnë përgatitjet?

- Këto ditë do të fillojmë provat në skenë, - u përgjigja shkurt.

- Këto ditë? Dhe kur bëheni gati për shfaqje?

- Besoj brenda fundit të muajit, - thashë.

Ai tundi kokën sikur donte të thoshte “e kuptova”, dhe mori në dorë diçka nga tavolina. Ndoshta një shkresë. Pastaj m’u drejtua me këto fjalë: “Të thirra për të të njoftuar vendimin e Byrosë. Lirohej nga detyra e drejtorit të shtëpisë së kulturës, dhe emërohej ‘redaktor’ në gazetën lokale...” Nuk e mbaj mend se ç’thashë në atë moment. Nëse u gëzova apo e kundërshtova në heshtje atë vendimmarrje të organit të nomenklaturës. Nuk e mohoj, puna në sektorin e kulturës dhe në atë detyrë më kishte dhënë kënaqësi. I kushtova gjithçka. Arrita të krijoj një rrjet të gjerë amatorësh, dhe me shumëllojshmëri veprimtarish t’i jepja jetës së rinisë një kuptim në atë qytet- xhep të Shqipërisë.

- Si... nuk të pëlqen? - u habit sekretari, teksa pa shprehjen indiferente të fytyrës sime.

- Sigurisht që më pëlqen, por...

- Nuk ka “por”, tani ka një vendim dhe...

- Por unë nuk jam gazetar, nxitova, duke ia ndërprerë fjalën sekretarit.

- Shkrimet e tua mjaftojnë, tha dhe u ngrit nga karrigia ku ishte ulur. M’u afrua, më ra shpatullave me pëllëmbën e dorës së tij të vogël, dhe nisi të më jepte porositë. Më tha se detyrën do ta dorëzoja në fund të muajit dhe në detyrën e re duhet të paraqitesha më 1 qershor.

“Fitorja” - emri i gazetës

“Fitorja”, - me këtë emër u pagëzua gazeta. Në fakt u diskutua për disa variante emërtimesh si, “Butrinti”,

apo “Jugu” e ndonjë tjetër, por me “shumicë votash” brenda komisionit, caktuar për këtë qëllim, u përzgjedh “Fitorja”. Debate pati edhe për formatimin dhe kompozimin e germave të titullit dhe të logos përkatëse. Edhe për këtë, në grupin e specialistëve, ku shumica ishin piktorë, u paraqitën disa variante. Fillimisht me një logo në formë flamuri, me të cilin dolën disa numra gazete, dhe më pas mbeti vetëm titulli “Fitorja”, pa logon, dhe kjo i rezistoi kohës.

Ishte fillimi. Ende nuk kishte përfunduar rikonstruksioni i mjediseve (ku janë sot zyrat e shoqatës “Omonia”) për zyrat e redaksisë së gazetës. Personeli dhe redaktorët e tjerë prisnin emërimin, me përjashtim të Spiro Pekos, instruktor i edukimit, i emëruar në detyrën e kryeredaktorit, Guro Zenelit dhe Dhimitër Trekos, një ekonomist banke, edhe këta në detyrën e redaktorit... Po punonim për numrin e parë të gazetës në kushtet e mungesës së përvojës. Duheshin përgatitje dhe eksperiencë. Saranda nuk e kishte një shtypshkronjë me teknologjinë e duhur për të realizuar prodhimin e një gazete. Ajo, që njëhej si “shtypshkronjë”, ishte në një mjedis pranë ish-ushqimores, ndërkohë që punohej për ta zhvendosur në mjediset e reja, mbi kinemanë e qytetit (sot, përballë hotelit të Çelajve). Ndërkaq priteshin makineritë dhe baza e nevojshme materiale për kompletimin e infrastrukturës së nevojshme që do të mundësonin shtypjen e gazetës.

Qendra (sektori i shtypit në Komitetin Qendror të Partisë) kishte vendosur, që deri në plotësimin e

kushteve (godina e shtypshkronjës së re, instalimi i makinerive etj, dhe kualifikimi i punëtoreve për të gjitha proceset e punës), gazeta të shtypej në shtypshkronjën e Gjirokastrës, aty ku shtypej edhe gazeta “Pararoja”, organ i komitetit të partisë të atij rrethi, dhe gazeta “Llaiko Vima”. Duhet të familjarizoheshim edhe ne me teknologjinë dhe procedurat që ndiqeshin për përgatitjen e një numri gazete, shtypjen në shtypshkronjë, dhe për të gjithë procesin e faqosjes, korrigjimeve në faqe etj., etj. Për disa vite mesjavat thuajse i kaluam në Gjirokastrë...

E premte, 6 gusht 1971. Një ditë e rëndësishme. Një ngjarje e madhe, që do të shënohej në “kalendarin” e ditës kombëtare të shtypit, 25 gushtit. Jo pa qëllim ishte lënë nxjerrja e gazetës lokale në këtë fillim gushti. Ishte një objektiv dhe objektivat duhet të arriheshin për të marrë më pas edhe përgëzimet e udhëheqjes së lartë. Por kjo ishte ana më e parëndësishme për ne gazetarët e rinj, që vumë gurin e themelit në daljen e saj, por dhe dashurinë tonë për ta bërë atë gjithnjë e më të pranueshme, më tërheqëse e më të lexueshme në rrugëtimin e saj ndër vite... Gëzimi ynë nuk kishte nuancat e qëllimeve politike të administratës partiake. Ne kishim një tjetër këndvështrim, mbase naiv për kohën, por të sinqertë së brendshmi në marrëdhënie me angazhimin në këtë punë, për t’i dhënë lexuesit jo

thjesht e vetëm mesazhe politike, por për të zbuluar të renë në vorbullën e ditëve, dhe për të shkruar për realitetet e kohës. Për të folur (brenda kornizave të lejuara) jo me gjuhën e propagandës, por për ta shndërruar e përdorur propagandën si mundësi për të thënë shumë të vërteta.

6 gushti na mbloodhi të gjithëve në një ceremoni, ku u mbajtën edhe fjalime. U thanë fjalë të mira, dhe u bënë urime nga i deleguari i qendrës, për ata që kishin firmën e tyre në këtë numër të parë. Për Spiron, si kryeredaktor, Dhimitrin, Guron... por dhe për ideatorin dhe këmbëngulësin deri në finalizim të projektit, sekretarin e propagandës, Spiro Çavo, që e bëri, siç tha, Sarandën me gazetë.

Po festa jonë, e firmëtarëve në këtë numër të parë, dhe punonjësve të redaksisë, do të ishte diçka e veçantë. Pas përfundimit të ceremonisë “zyrtare”, ne u mbloodhëm më vete në një festë “civile”, mes shokësh. Ishte festa më e bukur që nuk mund ta harroj, sikundër nuk mund të harroj interesin me të cilin e përcillnin këtë ngjarje punëtorët e ndërmarrjeve, kooperativistët në fshat, mësuesit, të gjithë lexuesit. Nga mbi 4000 kopjet e mbërritura nga Gjirokastra, të nesërmen (e shtunë) nuk kishte mbetur asnjë gazetë në redaksi...

Në dyvjetorin e gazetës

Në 2 vjetorin e botimit të gazetës, me rastin e ditës së shtypit (25 gushti), në shkrimin me titull “Atëherë

kur doli numri i parë...”, do të shkruaja: “Të gjithë e mbajmë mend atë 6 gusht, ashtu siç mbajmë mend ditëlindjet tona. Dhe siç mblidhemi për t’i festuar ato, të gjithë do të mblidhemi për t’i uruar mirëseardhjen gazetës sonë...” Lajmin, i pari, e dha postieri, që me tufën e gazetave në dorë bridhte dhe thërriste në rrugët e qytetit: “Blini gazetën ‘Fitorja’”. Pastaj mes atyre që pushonin dhe laheshin në plazh. Qytetarët e blinin gazetën dhe e tundnin atë si flamur... Sihariqi i parë i një lindjeje që u mësua kaq shpejt. E premtja e 6 gushtit 1971 hyri në ditët e shënuara për komunistët, kuadrot, punëtorët, kooperativistët, nxënësit, për gjithë lexuesit e gazetës “Fitorja”... Një urim edhe nga Kryesia e Bashkimit të Gazetarëve, në të cilin theksohet se “... gazeta ‘Fitorja’ do të bëhet një tribunë e gjallë revolucionare dhe mjet i fuqishëm për mobilizimin e masave punonjëse... Kanë kaluar dhjetëra numra qysh atëherë, kur, në familjen e madhe të gazetave, hyri dhe ‘Fitorja’, që me fjalën e saj e ka justifikuar më së miri misionin si propagandiste dhe agjitatore e flaktë... Me dhjetëra firma kanë lënë gjurmë në faqet e gazetës në këto dy vitet e para të jetës së saj, por nuk mund të harrohen të parët, ata që vunë firmat e tyre në numrat e parë si: Rexhep Skëndo, Koço Nika, Belul Korkuti, Aristidh Dhima, Aristotel Mëhilli, Thanas Peçi, Zamira Çavo, Jorgji Çakalli, Urani Miho, Marko Mavro, etj.

Është bërë zakon pritja e gazetës. E presin atë me kureshtje dhe dëshirë në çdo skaj të rrethit. Troket ajo

në dyer dhe hyn në çdo shtëpi. Të nesërmen një letër më shumë në redaksi, ku në secilën prej tyre shprehet mirënjohje...”

Udhëtimi vazhdon

Në krye të punëve, si kryeredaktor të gazetës, do të vinin të tjerë emra: Jorgo Melica dhe pas tij Guro Zeneli, një emër i njohur, që gëzonte popullaritet të gjerë mes banorëve në Sarandë, e më pas Kristaq Manthio. Secili me cv politike dhe joprofesionale në fushën e gazetarisë. Redaksia do të plotësohej gradualisht me emra të tjerë redaktorësh të fushave përkatëse. Ndër ta, Koço Kosta, një mësues letërsie dhe Sofokli Mekshi. Një tjetër mësues, Ilmi Jupe, nga Konispoli, që do të bënte punën e korrektorit letrar. Këta të parët, dhe më pas, Thoma Nika, një student i gazetarisë, fillimisht si stazhier dhe më pas në detyrën e redaktorit.

Ishim të rinj. Një grup kompakt dhe i përkushtuar në punë. Nuk mbaj mend të jemi grindur, të kemi mbajtur distancë, të kemi përgojuar a ofenduar njëritjetrin. Jo! Ishim si një familje, dhe familjet tona një e tërë në kuptimin solidar e social. Nuk njihnim stresin dhe as ankthin, pasi së bashku u bënim ballë edhe vështirësive.

Gjirokastra ishte qyteti ku gjetëm ngrohtësinë e kolegëve të gazetës “Pararoja”: Luanit, Sedatit, Avdullait dhe të gazetës “Llajko Vima” (ku punonte edhe Andrea Zarballa, pjesë e shoqërisë sonë), si

dhe gatishmërinë e punonjësve dhe specialistëve të shtypshkronjës. Mësuam mënyrën e radhitjes, të përgatitjes së faqeve, të korrigjimit dhe të procesit të shtypjes. Nisja drejt Gjirokastrës dhe qëndrimi atje çdo të enjte (gazeta dilte në treg të premten e çdo jave) deri në orët e vona të mbrëmjes, deri në përfundim të shtypjes së gazetës, ishte detyrim i secilit prej nesh, që priste me padurim radhën. Ishin udhëtime të këndshme, ku secili tregonte pozitivitetin e vet në bisedat e gjalla, por veçanërisht Ilmiu, që të shtonte adrenalinën, duke krijuar një atmosferë ndryshe me humorin e tij të hollë.

Gjatë viteve pati edhe ndryshime. Disa ikën (sikundër dhe unë) dhe të tjerë emra u bënë pjesë e stafit të gazetës, por me nostalgji kujtoj “skuadrën”, që çeli siparin që më tej i dha gazetës fytyrën dhe përmbajtjen e shëndoshë që pati ndikim në komunitetin e banorëve, duke krijuar një rrjet të gjerë bashkëpunëtorësh, si dhe duke shtuar progresivisht numrin e lexuesve. Për secilin mund të shkruaja pa fund, sepse secili ka një histori suksesi gjatë viteve të punës në gazetën “Fitorja”, por do të mjaftonin edhe pak radhë përkushtimi, për t’u thënë se nuk harrohen, pra nuk dalin lehtë prej kujtesës sime.

GURUA (Zeneli), njeriu energjik, i kudondodhur. Mendjehollë e “hazër xhevap”, si thotë populli. I dashur dhe komunikues shembullor, një familjar për ta pasur zili, dhe një penë e mprehtë që do të mbetej

dalluese për analizat shteruese të situatave, dhe goditëse për të metat dhe ata që neglizhonin punët e ngarkuara.

KOÇUA (F. Kosta), që çdo fjalë të nxjerrë nga goja e shoqëron me buzëqeshje. I ri në moshë, por i pjekur në logjikën e trajtimit të problematikave që duhet të përballonte gazeta. Një talent në mënyrën e të shkruarit, veçanërisht të reportazhit.

ILMIU (Jupe), i emëruar në detyrën e korrektorit, por që e kalonte përherë “gardhin”, duke shfaqur në mënyrë të befasishme talentin e një gazetari shumëdimensional. Ishte, edhe ky, një talent i reportazhit, por dhe i shkrimeve humoristike. Një ferment i socializimit dhe kompaktësimit të grupit.

SOFUA (Sofokli Mekshi), i emëruar si redaktor, pas diplomimit në Institutin Bujqësor për zooveteriner, do të sillte përvojën e fituar me shkrime në gazetën “Studenti i bujqësisë”, organ i rinisë studentore të atij instituti.

THOMAI (Nika), i pasmi. Ardhur nga auditorët e universitetit, fillimisht si stazhier. Ishte më i riu ndër ne, natyrshëm dhe këmbëngulës në përvetësimin e “sekreteve” të profesionit. Kishte çfarë të përfitonte nga ne, por edhe ne (më të vjetrit) gjenim e merrnim prej tij mënyrat e të shprehurit, stilistikën e përdorur gjithnjë e më mjeshtërisht, veçanërisht në reportazhet e tij.

Ne ishim të parët, por në atë gazetë, ndër vite, kanë lënë gjurmë emra, që me penën e tyre i dhanë jetë gazetës, ndaj nuk mund të harrohen: Enver Isufi, Shpresa Dine, i madhi Timoleo Mërtiri, Belul Korkuti, Abdul Dule, Bardhyl Bejko, si edhe bashkëpunëtorë të pandashëm prej saj, si Feruz Shabani, Urani Miho, Silvana Isufi, apo penat e satiristëve si Hasan Nikolla e Nasho Koça, por edhe dhjetëra të tjerë, që me shkrimet e tyre ndër vite i dhanë gazetës “ushqimin” e përditshëm, në pasqyrim të ngjarjeve të kohës.

Gazeta “Fitorja” ishte organ i komitetit të partisë, dhe, natyrisht, syri dhe fjala e këtij institucioni drejtues e dominues të të gjithë jetës në këtë rreth. Si e gjithë media e kohës, edhe kjo gazetë ishte një mjet komunikimi me masat, dhe njëherësh instrument i shtetit dhe i partisë, çka do të thotë se informimi dhe çdo material i botuar duhet të ishin në përputhje me parimet ideologjike dhe politike të partisë. Po a i qëndruam ne strikt kësaj vije? Do të gënjeja nëse do të thosha jo. Veçse kurrë gazeta nuk bëri elozhe, nuk i kaloi në heshtje dukuritë negative, indiferentizmin, po ashtu edhe sjelljen autoritare të drejtuesve, që abuzonin, tejkalonin kompetencat, apo neglizhonin detyrat për interesa vetjake në dëm të shoqërisë, punëtorëve, kooperativistëve, etj.

Të përkushtuar në misionin tonë, idealistë në qëllimin e përditshëm për të rritur cilësinë e për t'i dhënë lexuesit në dorë një produkt të vlefshëm, në pak kohë e radhitëm “Fitoren” ndër gazetatat lokale

më të mira, me një tirazh domethënës. Një gazetë që dallohej jo vetëm nga forma (nga mënyra novatore e faqosjes), por edhe nga përmbajtja, nga larmia e tematikave dhe e problemeve, që trajtonte përmes rubrikave të shumta me tema shkrimesh që e zbusnin sadopak ngarkesën ideologjike e partiake të çdo numri. Gazetës nuk i mungonin rubrika të tilla si: “Tema shoqërore”, “Tabela e qitjes humoristike”, “Syri ynë”, përmes të cilave viheshin në shënjestër fenomenet negative dhe individë drejtues abuzator. Nuk mungonin as gjini gazetareske si “Fejtoni”, “Skica humoristike”, “Reportazhi”, “Portreti” dhe faqet letrare periodike.

Nuk vonoi dhe shtypshkronja në Sarandë u vu në gatishmëri për të realizuar, veç proceseve të tjera dhe atë të nxjerrjes së gazetës. Ishte montuar makina e shtypit, ajo e prerjes dhe palosjes, si dhe kishin mbërritur fashikujt e parë me letër gazete. Ishte e premtja e parë e shtatorit të vitit 1976, dita kur shtypshkronja në Sarandë prodhoi për herë të parë gazetën “Fitorja” dhe atë ditë e mbaj mend që e festuam. “Shiritin” e inaugurimit e preu përfaqësuesi i Komitetit të Partisë, ndërsa ne, redaktorët, punonjësit e prapavijës së gazetës (daktilografistja, shoferi, pastruesja), si dhe ata të shtypshkronjës: Thanas Papai, kryemekaniku, Thanas Angjeli, përgjegjës i shtypshkronjës, Dhoksia, Luli, Arta - radhitëset.

Makinistët Dhimitër Bruzho e Andon Nika, njëherësh dhe specialistë të përdorimit të makinës së sheshtë të shtypit. Palosëset: Shpresa dhe Kalo Spiri... Të gjithë “firmosëm procesverbalin” e fillimit të një dite të re pune, si një kolektiv i përbashkët.

Shkrimet e numrit të radhës duhet t’ia dorëzonim kryeredaktorit jo më vonë se një ditë para daljes së gazetës, me përjashtim të rasteve kur, për arsye madhore, duhej botuar diçka e paparashikuar. Ndërsa puna në shtypshkronjë vijonte pa ndërprerje dhe arrinte kulmin pasditen dhe mbrëmjen e së enjtes. Për arsye se radhitja e shkrimit bëhej me shkronja plumbi, një nga një, por që edhe për shkak të nxitimit për formimin e radhëve, bëheshin gabime të shumta. Kështu, së bashku me radhitëset na duhej të punonim, shpesh deri në të gdhirë, që të eliminonim gabimet, të cilat nuk mund të shmangeshin pa një përkujdesje të rreptë për korrigjimin e çdo boce apo faqeje deri në provën pas shtypit të kopjes së parë. Dy vite më pas, me përmirësimin e teknologjisë së radhitjes, situata ndryshoi për mirë. Shtypshkronja u pajis me një makineri të re për prodhimin e rreshtave me derdhje, e quajtur “Linotip”. Por edhe pas kësaj gabimet e bëra nga linotipistët: Mihali, Piroja, Dhoksia e Luli, ndonëse më të pakta, na nxirrnin punë neve redaktorëve përgjegjës, që kryenim shërbimin sipas radhës, në shtypshkronjë...

Edhe sot, pas disa dekadave, kujtoj me nostalgji atë bashkim shpirtëror mes shokësh, që pavarësisht radhës për të ndjekur procesin e nxjerrjes së gazetës,

mbilidheshim të gjithë dhe punonim për t'i bërë sa më shpejt korrigjimet e gabimeve nëpër boca, dhe kështu i kalonim gëzueshëm orët e pasdites deri në orët e vona të të enjteve. Nga të gjitha episodet e atyre orëve, që na çlironin adrenalinë dhe na krijonin situata deri euforike, duke na përfshirë të gjithë në një botë gati virtuale, në sytë e mendjes më qëndron ky episod: Timoleo Mërtiri (gazetari që provoi “dhëmbët” e regjimit të kohës, i dërguar në prodhim në metalurgji) pas botimit, në gazetën “Bashkimi”, të shkrimit “Ku qafa e Pazarit, ku Dunavati”, atëkohë një burrë rreth të pesëdhjetave, nuk dallonte për nga mënyra e sjelljes nga grupi tjetër i kolektivit të gazetarëve, ndonëse me diferencë të madhe në moshë. ... Atë natë na u desh të qëndronim deri në agim, për shkak të një defekti në makinën e shtypit. Ishim grumbulluar në korridorin e gjerë, mes repartit të radhimit dhe atij të shkrimit të materialeve në linotip, kur mes debateve e shakave që kush ishte më i forti i grupit, Timua (që nuk jeton më) i drejtohet Thodhoriut (fatkeqësisht, i ndarë në moshë të re, shumë vite më parë nga jeta), shoferit të gazetës, - i liruar pak vite më parë nga ushtria - që të provonin bashkë forcën. “Me mua do ta hash ti?”, e pyeti i habitur Thodhoriu. “Pse jo. Kujton se je më i fortë se unë”, ia ktheu Timua me shpoti, por serioz sa Shozhua (kështu e thërrisnim Thodhoriun) ishte duke besuar vërtet. Dhe Timua vazhdoi lojën duke e pyetur për moshën, dhe kur dëgjoji Shozhon të thoshte 25, tha: “25? Pun’ e madhe, je 10 vjet më i ri se unë, por kjo nuk do të thotë se je më i fortë. Hajde, ta mban?... ”

Të betohem se të hedh tuç me të parën...” Shozhua shtangu dhe ne ia shkrepëm gazit. Pastaj Timua e përqafoi dhe i tha se bënte shaka...

Të gjithë përpiqeshim të bënim më të mirën. Secili kishte një plan për temat dhe shkrimet që duhet të dorëzonte për numrin e radhës. Këtu përfshiheshin edhe shkrimet e bashkëpunëtorëve (korrespondentëve vullnetarë), emrat e të cilëve ishin të pashmangshëm në çdo numër gazete. Natyrisht kishim edhe liri veprimi, çka do të thotë se temat e shkrimeve i përzgjidhnim vetë dhe bënim ndryshime në planin e miratuar, kur dilte diçka e re, një ngjarje që duhej pasqyruar ose një problem më i rëndësishëm që do ta bënte gazetën më të lexueshme. Duhet thënë se punonim në kushte që sot duken si paradoksale. Kishte vështirësi për të marrë informacion pasi mungonte infrastruktura e komunikimit. Me një telefon statik, me të cilin lidheshim me ndërmarrjet apo me qendrat e kooperativave (kur të na e mundësonte centralistja e postës), ishte e pamundur të siguroje në kohë informacionin, veç çka njoftonin korrespondentët vullnetarë. Ne, redaktorët, për një shkrim problemor, për konfirmimin e faktit, na duhej të shkonim atje ku ishte burimi, në fshat, në ndërmarrje dhe... mund të qëndronim me ditë për të siguruar provat e nevojshme para se të hidhnim në letër atë që kishim në “kokë”. Nuk mund të bëhej shaka, duke shkruar gjëra të

paqena dhe më keq të abuzonim me shtrembërim faktesh. Gjej rastin ta them se “liria e të shkruarit” nuk na cenohej, por pa kaluar kufijtë kur shkrimi përmbante të pavërteta, apo kur shkelej “vija e kuqe”, që do të thotë kur steka e kritikës ngjitej në nivelin e moslejimit nga nomenklatura. Edhe kur mund të bije, mbase pa dashur, viktimë e censurës së padukshme (autocensurës), ndodhte që guximi ynë ta kalonte gati me sportivitet, pa e ndier peshën e saj.

Shembujt janë të shumtë. E kemi provuar të gjithë, natyrisht edhe unë, që ndonëse nga përgjegjësia që kisha si drejtues i partisë në kolektivin e gazetës dhe të shtypshkronjës, duhet të isha “syri vëzhgues” edhe i të tjerëve, për të “qëndruar brenda kufijve” të lejimit. Por e them pa droje se isha vetë i pari që gjeja “shtigje” për të dalë nga këto kufizime dhe për ta zhvilluar në gazetë, jo luftën e klasave, por luftën me të metat e konstatuara, dhe për të zhvilluar sensin e kritikës jo me fjalë, por me emra konkretë. Natyrisht, kritika jo gjithnjë mirëpritej e kapërdihej nga individët, nga drejtues sidomos, sepse kishte nga ata që mbanin kokën mënjanë apo ankoheshin. Por vetëm kaq. Ajo e bënte efektin, sepse faktet ishin gjithnjë kokëforta, ndaj dhe të kritikuarit bëheshin edhe objekt i kritikës së organizatave të partisë, apo i kolektivave punonjëse. Kjo ishte forca e fjalës dhe “hija e rëndë” e gazetës “Fitorja”. Shkrimet e mëposhtme e ilustrojnë këtë fakt.

Vangjel Këmba qenka bërë brigadier?

(“Fitorja”, 9 mars 1973)

Ç’është e vërteta, Vangjeli, detyrën e brigadierit në sektorin e pyjores, Kalasë, vetëm një muaj e kreu.

Atë muaj, kur përgjegjësi i sektorit, Stavri Kaishi, dhe brigadierja, Lefteri Spiro, u larguan pa pritur e kuptuar nga puna, drejtoria e ndërmarrjes ngeli, siç thotë populli, me gisht në gojë. Ndërsa punëtorët e sektorit pa komandë. Por, mirë thonë se “po shtrydhe trutë, mendimet dalin të pjekura”. Dhe i shtrydhën trutë ata të drejtorisë së ndërmarrjes. Në fakt shefi i kuadrit, i cili thirri, në një moment trushtrydhjeje: “Eureka!!”. Dhe ia ktheu drejtori: “E gjete?”. “Po. Kemi atje, Vangjelin, ta ngremë në përgjegjësi”. U menduan ca dhe vendosën ta emëronin Vangjelin brigadier. Do të pyesni ju kush është Vangjel Këmba. Po ua them unë.

Para disa vitesh punonte si magazinier në ndërmarrjen e grumbullimit. Dhe një ditë i tha vetes: “Merr, o Vangjel diçka nga këto mallra që ke këtu se nuk bëhet qameti. Fundja kush të shikon...”. Dhe kështu bëri, por..., e zunë me presh në dorë, dhe e çuan pas hekurave “për të vënë mend”. Nuk e lanë pa punë pas lirimit. U punësua në sektorin e pyjores...

Fillimisht, Vangjeli ishte nën hyqmin e përgjegjësit të ri të sektorit, Nestit, i cili drejtonte edhe brigadën e mbetur pa brigadier. Por Nesti Gaxhijani, si i ri në moshë, dhe “pa përvojën e duhur në drejtim”, nuk

e kishte besimin e drejtorit, prandaj ai i ngarkoi Vangjelit edhe detyrën e konsulentit të përgjegjës! Dhe të rrimë shtrembër e të flasim drejt, Vangjeli, nuk e bënte “spiunin” edhe se Nesti, largohej shpesh nga puna, mjaft që të mbetej mes brigadës femërore, si gjeli mes pulave: përgjegjës dhe brigadier.

Unë jam Stefua nga Dërmishi
(autoportret)
(“Fitorja”, 19 tetor 1973)

E vërteta është se këtu në Dërmish më njohin rrënjë e dhëmballë. Cilindo që të pyesësh do të thotë se “Stefo Jidhari është me emër, jo vetëm në Dërmish, por në gjithë rrethin. Është kryetar i frontit demokratik të fshatit, dhe i ka dhënë vetes të drejtën të merret me biografitë e çdonjërit, duke i bërë të paqenat të qena”. Ka të tjerë që më ngarkojnë pesha edhe më të rënda. Por asgjë nuk është e vërtetë. Të vërteta janë vetëm ato që them unë, fjalët e mia, sepse më shumë sesa e njoh unë veten nuk më njeh askush tjetër.

Këtu në Dërmish, më janë qepur me bukë në trastë. Nuk më duan, sepse unë nuk lë gurë pa lëvizur, dhe letra pa shkruar, sidomos ndaj atyre që më janë bërë ferrë nëpër këmbë. Po, dreqi e mori, në mbledhjet e organizatës së frontit bëhen të gjithë në një mendje, dhe dalin kundër meje. Ama edhe unë ua kamë gjetur ilaçin! E kaloj natën duke shkruar letra..., nga ato anonimet, dhe ua dërgoj shokëve të kryesisë së rrethit.

Kam dërguar edhe një shkrim në gazetën “Fitorja”... Kritikoja hapur përgjegjësin e sektorit, sekretarin e organizatës, brigadierët dhe disa komunistë, që e kanë katandisur sektorin si mos më keq. Megjithëse shkrimin nuk e pashë të botuar në faqet e gazetës, ndihem i kënaqur se ua kam nxjerrë të palarat në shesh.

Le të flasim hapur e me zemër në dorë, si thotë populli. Nuk është se jam i pagabueshëm. Në fund të fundit edhe unë njeri jam. Po gabimet e mia nuk janë në atë shkallë sa të më bëjnë të tjerët qepaze në mes të fshatit dhe të kërkojnë shkarkimin tim nga detyra e kryetarit të organizatës së frontit! Dhe kë duan të shkarkojnë? Mua!? Jo, jo... Kam akoma forca të luftoj me ta. E kam seriozisht. Ju them, por mos e bëni bujë dhuntinë time për t’ua gjetur anën ca kritizerëve. Jam ca finok ç’është e vërteta. Dhe ja: Aty nga fundi i muajit shkurt të këtij viti u shtrua me beton stalla e kuajve (unë isha rojë atje). E dija që betoni ishte ende i njomë dhe nuk duhet të fusja kuajt. Kisha dhe urdhër për këtë. Por unë i futa kuajt qëllimisht, për të përgjegjësuar brigadierin. 16 metra katrorë, e shtruar me beton, u prish. 200 lekë vajtën dëm. U mbajt një procesverbal, i cili ende fle në zyrën e përgjegjësit të sektorit. Unë nuk i pagova lekët. Një punëtor i sektorit më vuri fletërrufe. Fjala ishte për disa shtylla betoni e disa tulla që, sipas tij, i kisha vjedhur unë. “Interesant, - thashë. - Ku më pa ky mua?” Nuk e hapa gojën, veç punëtorin në fjalë e vura vëth në vesh. Jam fajtor për një gjë. Nuk ia

dhashë lekët ustait që dogji kaminën e gëlqeres. Në fund të fundit çdo humbisja? 2500 kg gëlqere i shita privatisht...

Si ua nxë goja, xhanëm, disave, kur thonë se paskam përvetësuar 600 lekë nga kuotat e organizatës? Çdo ditë që kalon, mosmarrëveshjet me ta shtohen. Kujtdo ia përplas surratit, dhe, ç'është e vërteta drejtpërdrejt askush nuk guxon të më flasë, se ma kanë frikën. Edhe agronomi i sektorit mbajti një procesverbal, duke më ngarkuar dëmin e shkaktuar nga kuajt në perimet e mbjella. Unë ia preva shkurt përgjegjësit, duke i thënë "në qoftë se unë duhet të paguaj, ti je për hekura..." Ai u tremb dhe nuk e zgjati më... Para disa ditëve paralajmëruan gruan time për largim nga çerdhja ku punonte, por unë e urdhërova të mos e dorëzonte çelësin. Por nuk më eci. Kryetari i këshillit ia mori çelësin e çerdhes dhe unë fillova sulmin. Nisa disa letra drejt Komitetit të Partisë. Ua kam bërë biografinë të gjithëve. Ta marrin vesh se me cilin kanë të bëjnë. Më thonë Stefo Jidhari, nga Dërmishi.

Kur kalohet vija e kuqe

Kam thënë se në punën tonë, në procesin e të shkruarit dhe deri në botimin e shkrimeve, nuk e ndienim peshën e censurës. E vërteta është se shkrimet kontrolloheshin nga kryeredaktori (dhe në raste të veçanta nga sekretari i propagandës), por rrallë ndodhte që ai t'i kthente ato mbrapsht,

apo të bënte vërejtje thelbësore. Sektori përkatës në Komitetin e Partisë së rrethit, nuk i “fuste hundët” në kontrollin e përmbajtjes së shkrimeve të çdo numri që futej në shtyp. Në këtë vështrim censura e sistemit ishte e padukshme, ndërkaq duhet thënë, që ajo ka të bëjë me autocensurën. Ne, përgjithësisht, e dinim sa “i gjatë ishte jorgani”, dhe shtrinin këmbët në vartësi të kësaj gjatësie. Kur këmbët dilnin nga jorgani, shkurt kur vija e kuqe kalohej, binin edhe kambanat e alarmit, sikundër ka ndodhur në një rast, pas botimit të shkrimit “Edhe emrat dhe emërtimet kanë karakter klasor”, autor i të cilit ishte redaktori, që mbulonte sektorin e kulturës, Enver Isufi.

Shkrimi me këtë titull, në fillimarsin e vitit 1976, tronditi gjithë superstrukturën partiake të rrethit dhe krijoi një turbulencë qëndrimesh e opinionesh, jo vetëm brenda kolektivit të gazetës.

Çështja e ndërrimit të emrave ishte temë dite pas një udhëzimi qeveritar për të gjitha zyrat e gjendjet civile, sipas të cilit, ato jo vetëm mund e duhet të propagandonin, por dhe të bindnin prindërit, kur shkonin për të regjistruar fëmijën e lindur, të përdornin një nga emrat që përmbante “lista e emrave të rinj”, që disponohej nga çdo zyrë e gjendjes civile. Në këtë debat ishte përfshirë edhe ndryshimi i emërtimit të disa toponimeve dhe fshatrave, sidomos në zonën e minoritetit grek të rrethit. Këtë tematikë, që në atë kohë nuk përbënte thjesht një praktikë të zakonshme, dhe nuk ishte thjesht çështje teknike, por, më shumë se

kaq, kishte një prapavijë politike, pse jo dhe shpjegim ideologjik, redaktori i “Fitores”, Enver Isufi, vendosi ta trajtonte në shkrimin e tij.

Me shembujt që ai sillte nga zona e Vergoit, ku përgjegjësi i atjeshëm i gjendjes civile, duke i vënë përpara listën e emrave të rinj që rekomandoheshin, shpjegon se si familjet e reja tregoheshin entuziaste dhe të gatshme që t’i braktisin emrat tradicionalë, por me prejardhje, sipas tij, turkoshake, si Osman, Hamdi, Sami, Hajdar, Kafaze, Ballkize, Sulltane... dhe t’u vendosnin fëmijëve emra të rinj (që i përmbante lista) si Trim, Blerim, Drita, Dritan, Ndriçim... Për t’i dhënë një shpjegim teorik kësaj praktike, autori i shkrimit e argumentonte këtë si nevojë të kohës, si risi që e diktonte vetë sistemi, sepse sipas tij, edhe emri shpjegon në vetvete epokën, kohën, sistemin... se vetë emrat kanë evoluar nga koha në kohë dhe se në një shtet socialist, ku sundon ideologjia e klasës punëtore, emrat duhet të kenë karakterin e saj, pra t’i përshtaten evolucionit...

Me të njëjtën logjikë autori i shkrimit trajton edhe arsyen (dhe justifikon faktin) e ndryshimeve që u ishin bërë disa vendbanimeve. Por ai i kategorizon këto ndryshime, si nevojë. Së pari, për të hequr emra të papërshtatshëm me ngjyrimet ofenduese, si p.sh. “Vromero”, që në gjuhën greke do të thotë ujë i qelbur. Së dyti, si nevojë e largimit të hijes së ish-pronarëve, të çifligarëve, të cilët u kishin dhënë disa fshatrave emrat e tyre, si Hadëraga, Imerefendi, Salibej, Karalibej, etj. dhe zëvendësimin e tyre me emra të rinj, të kohës

së re “që po lindte”. Së treti, si nevojë e zbatimit të direktivës për luftën kundër besimeve dhe praktikave fetare, duke zhbërë jo vetëm fizikisht objektet e kultit, por dhe duke fshirë emrat dhe emërtimet me karakter e përmbajtje fetare të disa vendbanimeve në rreth, si Shënvasil, Theollogo, Shënjan, Shëndre etj. Dhe së fundi, si nevojë e “përshtatjes” së disa emërtimeve në gjuhën greke me emërtime në gjuhën shqipe si “Dritas” në vend të “Fanari” e ndonjë tjetër.

Pak a shumë këto çështje trajtonte autori në shkrimin “Edhe emrat dhe emërtimet kanë karakter klasor”, shkrim që u bë objekt debati, analizash kritike në redaksinë e gazetës, dhe në forumet e partisë në rreth. Pse?

Tri ditë pas daljes në shitje të atij numri të gazetës “Fitorja”, telefoni në zyrën e sekretarit të parë ngriti furtunën që pasoi zhurmën shurdhuese të ziles. Jordan Pani, sekretar i parë i KP-së së rrethit, pasi dëgjoi i heshtur ligjërimin, me zë disi të ashpër të folësit në anën tjetër të telit, ra si deng në ndenjësën - kolltuk, dhe, si ta kishin goditur me kamxhik, uli kokën mbi tavolinën e punës dhe nuk lëvizi për një kohë të gjatë... Më pas i ra ziles dhe porositi sekretaren t’i sillte gazetën “Fitorja”.

E kishin telefonuar nga KQ i Partisë, sektori i propagandës dhe shtypit, dhe i kishin tërhequr vëmendjen për botimin në gazetën lokale të shkrimit “Edhe emrat dhe emërtimet kanë karakter klasor”. I kishin thënë se ai shkrim nuk duhej lejuar të botohej dhe se ai, dhe sekretari i propagandës duhet të mbanin

përgjegjësi për këtë, sepse nuk e kishin kontrolluar, para botimit, materialin. Porosia (në fakt, urdhri) ishte e prerë për analizë në redaksi, ndërsa në Byronë e Partisë të merreshin masa për neglizhuesit...

Në mbledhjen e kolektivit të gazetës mori pjesë vetë Jordan Pani, sekretari i parë i KP-së së rrethit. Ishte një mbledhje “tërkuzë” e gjatë, ku nuk munguan kritikrat, autokritikat, analiza e shkaqeve që çuan në botimin e shkrimit, shpjegimi i arsyeve pse nuk duhej botuar shkrimi, keqkuptimet e krijuara, pasaktësia teorike e trajtimit etj. dhe “mbi të gjitha rëndon incidenti që shkaktoi shkrimi në marrëdhëniet me Greqinë”, tha në mbledhjen-analizë, sekretari i parë. Sipas tij qeveria greke, përmes Ministrisë së Jashtme, kishte dorëzuar në Qeverinë Shqiptare një notë-proteste, ku akuzonte Presidiumin e Kuvendit Popullor që kishte ndërmarrë nisma ligjore dhe një fushatë “të pamatur”, siç ishin ato të zëvendësimit të emrave me karakter e përmbajtje fetare dhe në gjuhën greke, me emra shqipfolës etj. “Shkrimi në gazetë doli pikërisht pas kësaj kur ende nuk janë mbyllur polemikat dhe qartësimet në rrugë diplomatike mes dy shteteve”, tha sekretari i parë i partisë.

Sikundër rezultoi edhe nga diskutimet, në atë mbledhje-analizë, për shkrimin, gabimi qëndronte kryesisht në titull, i cili edhe ideologjikisht nuk qëndronte, pasi emrat nuk mund të kenë karakter klasor. Nga ana tjetër turbulenca dhe pasojat politike, që krijoi shkrimi, sidomos në raport me pretendimet e qeverisë Greke, kishin të bënin me frikën e një fushate

(ky rast krijonte një dyshim të arsyeshëm për ta) për heqjen e identitetit fetar të popullsisë minoritare, dhe të cenimit të integritetit tokësor përmes çëmërimëve dhe rriemërimëve të vendbanimeve, dhe zëvendësimit të emrave në gjuhë e përmbajtje autoktone, në gjuhën shqipfolëse etj.

Dukshëm ishte kaluar vija e kuqe, dhe kjo nuk mund të tolerohej. Autori i shkrimit u largua nga gazeta, dhe sekretari për propagandën, Sokrat Bejo, për “paaftësi dhe mungesë të vigjilencës ...” (në fakt ai nuk e kishte lexuar fare shkrimin), u shkarkua.

Deri ku duhet ngritur steka?

“Kritika në gazetë është si kripa në gjellë”, thoshte Ilmiu, sa herë që diskutonim mes nesh për problematika të veçanta dhe tema shkrimesh ku duhej të evidentoheshin të metat, shkaqet e tyre, por duhej bërë edhe kritika për individë, drejtues apo organizata partie përgjegjëse, anëtarë të tyre etj. Gazeta “Fitorja” dallohej për sensin kritik, dhe veçanërisht për përdorimin e saj në një formë “të kamufluar” përmes shkrimeve satirike, fejtoneve etj. Natyrisht, jo në “tejkalim të masës”. Pas asaj që ndodhi me shkrimin “Edhe emrat dhe emërtimet kanë karakter klasor”, udhëheqja e partisë ishte bërë më vigjilente, për ta mbajtur “stekën” e kritikës në gazetë brenda masës së lejuar. Ky kufi nuk mund të kapërcehej për individë në detyra të rëndësishme në ekonominë bujqësore a

në ndërmarrje, në funksione shtetërore dhe sidomos në ato të zgjedhura në forumet partiake të rrethit, etj. Kur ndodhte kjo, pra kur steka e kritikës ngrihej mbi nivelin e lejuar, aty niste problemi dhe gazetari bëhej objekt i analizave në parti.

Në funddhjetorin e vitit 1977 kryeministri i vendit, Mehmet Shehu, ishte në Sarandë, në një vizitë pune (siç flitej për të përgatitur terrenin për vizitën që do të bënte disa muaj më pas udhëheqësi i partisë, Enveri). Ai kishte konstatuar, gjatë rrugës për në Sarandë, se misri në parcelat e mbjella (të cilat i përkisnin kooperativës së Finiqit) ishte ende në fushë, i pakorrur, edhe se afatet ishin tejkaluar dhe shirat rrezikonin dëmtimin e prodhimit. Kishte dhënë alarmin për këtë. Më thërret në zyrë sekretari i propagandës, Thanas Vaso (një jurist me përvojë në profesion, por dhe person që dallohej për nivelin e komunikimit, lidhur me gazetarët, dhe mbështetës për punën e tyre), i cili më shpjegon situatën në kooperativën e Finiqit lidhur me gjendjen e misrit dhe porositë që kishte lënë kryeministri...

- Po më thoni se duhet shkruar në gazetë? - pyeta instinktivisht.

- Duhet bërë një shkrim i fortë, në këtë numër të gazetës.

- Kur thoni “ i fortë”, në ç’kuptim? - pyeta.

- Në kuptimin e kritikës. Si mundet që anëtarët e partisë atje ta kenë toleruar këtë situatë. Si mundet që organizata të mos e ketë bërë problem, por të vijë e ta

konstatojë kryeministri?...

“Është në të drejtën e tij sekretari, që flet i revoltuar, me siguri kryeministri i ka shkundur”, thashë me vete, pastaj iu drejtova me këto fjalë:

- Kuptohet që organizata e partisë në Finiq ka përgjegjësi, por kritika mendoj duhet drejtuar edhe tej organizatës.

- Natyrisht. Brigadierët, përgjegjësi i sektorit...

- Po të tjerët? - pyeta.

- Cilët të tjerë, - tha me nxitim.

- Kryetari. Mbi atë bie e gjithë barra.

- Jo, jo... nuk mund të kritikojmë në gazetë, publikisht, një anëtar byroje...

- Po ç’kuptim ka që...

- Mos na mëso se ç’duhet bërë, Panajot, - ma preu shkurt, dhe vijoi: - Përgjegjësia e tyre do të diskutohet në byro..., por mos të humbim kohë... Shkrimi duhet të dalë pasnesër, - tha, dhe më përcolli te dera.

Kontaktova kooperativistë, sekretarin e organizatës-bazë, brigadierë dhe drejtues të sektorit për të kuptuar se ç’i kishte penguar për të mos e korrur në kohë misrin, dhe për shqetësimin ose jo të krijuar për këtë situatë etj.

Në shkrim theksova faktin se një nga arsyet e situatës së krijuar nga vonesa në korrje, kishte të bënte me kushtet e papërshtatshme atmosferike (sipas drejtuesve

të sektorit) për shkak të shirave të vazhdueshme. Po, sipas tyre, kishte munguar edhe mbështetja nga kryesia me autokorrëse dhe me njerëz. Ndërkaq vetë kryetari ankohej për rrethin... Dhe shkrimi, ku trajtohej problemi dhe jepej një panoramë e plotë e gjendjes, nuk përmbante vetëm analizën e faktorëve ndikues dhe të shkaqeve për këtë prapambetje, por dhe emrat e shkaktarëve. Në fakt, “e preva në besë” sekretarin e propagandës, pasi në atë shkrim kritik nuk munguan as emrat e drejtuesve të kooperativës apo të Komitetit Ekzekutiv të Rrethit, deri në nivel të nënkryetarit që merrej me bujqësinë, etj.

Shkrimi ra si bombë dhe krijoi jo pak shqetësim te të kritikuarit. Më thirri vetë sekretari i parë, Jashar Menzelxhiu, dhe më “shkuli” veshin për këtë “pamatur”, siç e cilësoi ai përmbajtjen kritike të shkrimit. Por vetëm kaq për momentin. Të kritikuarit, me ndikim pushteti, kuptohet, “mbajtën shënim”, dhe kërkuan (natyrisht jo hapur) që të merrej një masë ndëshkuese ndaj gazetarit që kishte guxuar t’u përmendte emrin, duke i “diskredituar” në popull...

Reportazhi që nuk u shkrua

Ishte fillimmarsi i vitit 1978. Vjeshta dhe dimri i lagësht kishin krijuar vështirësi serioze në përgatitjen e tokave për mbjelljet e pranverës. Udhëheqja e partisë dhe drejtuesit e pushtetit në rreth ishin në situatë alarmi. U mblodh me urgjencë plenumi i Komitetit të

Partisë, që shkundi, në njëfarë mënyre, indiferencën e pritjes së drejtuesve në ndërmarrjet dhe kooperativat bujqësore. Vendimi: e gjithë mekanika bujqësore në funksion të mbjelljeve. Të gjithë traktorët në punë, edhe natën, për plugimin e tokave...

M'u kërkua që ta ndiqja në terren dhe të pasqyroja në gazetë punën, në zbatim të vendimit të forumit më të lartë të partisë në rreth. Mendova se një reportazh për të pasqyruar angazhimin e mekanizatorëve dhe punonjësve të bujqësisë, do të ishte veprimi i duhur, si fillim. E bisedova me Ilmiun, i cili më sugjeroi që të dilnim në mbrëmje dhe të shkruanim për traktoristët...

Në perëndim të diellit u nisëm drejt Ksamilit. Pandi, shoferi i gazetës, Ilmiu dhe unë, u ndalëm fillimisht te bërryli i rrugës që zbret drejt Butrintit, prej nga kishim një pamje për gjithë hapësirën e fushës së Vrinës dhe Konispolit. Errësira ishte e plotë, veç fshatrave. Qëndruam për rreth një orë dhe nuk mundëm të identifikonim mjete në punë. As zhurmë dhe as drita në fusha. U kthyem mbrapsht, dhe po e njëjta situatë në fushën e Çukës, por dhe më tej, në fushat e Dritasit, Qenurjos..., derisa mund të të kapë syri në orët e ditës. E njëjta situatë dhe në fushat e Vurgut, Finiqit, Mesopotamit dhe Alikos. Vendosëm të shkonim më tej, të bindur se diku do të gjenim, mbase, edhe një traktor në punë. Pas një ore mbërritëm në Livadhja, pa identifikuar mjete në plugim tokash. Shpresa mbetej fusha e Vagalatit. U nisëm për atje pa humbur kohë. Autovetura, në dalje të Livadhjasë, stopoi në baltën e rrugës, dhe na u desh ta nxirrnim me